

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2023

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295
E-mail info@kesh.al
Ueb-faqe www.kesh.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik , ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: NR.REF- 57159-01-26-2023.

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Riparim, mirëmbajtje makina dhe automjete për një periudhë 2 (dy) vjecare”.

5. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 80,580,000 (Tetëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH ose 692,149 (Gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzetë e nëntë) Euro pa TVSH.

Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është :** 244,145,148 (Dyqind e dyzetë e katër milion e njëqind e dyzetë e pesë mijë e njëqind e dyzetë e tetë) Lekë pa TVSH ose 2,097,106 (Dy milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 26/01/2023 është 116.42 Lekë/Euro.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 (njëzet e katër) muaj.

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 17/02/2023 (d/m/v) Ora:10.00.

Afati për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42 pika 6 të LPP shkurtohet pasi:

Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të AK, kategorizohet tek shpenzimet operative të domosdoshme, pasi lidhet me mbarëvajtjen e punës së kompanisë dhe sigurinë e shëndetit dhe jetës së punonjësve të cilët udhëtojnë me këto mjete që kanë nevojë për riparim.

Referuar situatës aktuale, dhe nevojës emergjente për riparime paraqitet e nevojshme që procedura e kërkuar të realizohet në një afat më të shkurtër (se ajo standarte 35 ditë në këto raste), pra të realizohet për 22 ditë, e vlefshme, kërkuar dhe propozuar kjo nga AK duke patur parasysh se jemi në periudhën e dimrit, ku automjetet e KESH sh.a dhe Njësive të Prodhimit Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës kërkojnë riparime emergjente, ku edhe nga ecuria e zbatimit të kontratës riparimi i tyre është konsideruar dhe konsiderohet domosdoshmëri.

Pra jemi në një rast, ku nevoja për shërbime emergjente riparimi nuk do mund të mbulohej menjëherë.
Argumentuar sa më sipër, AK vendos shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave nga 35 ditë në 22 ditë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho